



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK**

Nr. _____ Prot.

Shijak, më ____ . ____ .2022

RELACION

Bashkia e Shijakut, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 9, pika 1.2, ushtron të drejtën e pronësisë, duke ushtruar të drejtën për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet në pronësi të saj, brenda kufijve të caktuara nga ligji. Si person juridik gëzojmë dhe ushtrojmë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi.

Relatimi I ketij projekt- vendimi “Për miratimin e tjetersimit e këmbimin e pronës ish Pallat Kulture ,dalë jashtë funksionit nga tërmeti i 26- nëntorit 2019 ,pronë e përfituar me VKM Nr. 839 datë 22.07.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike shtetërore që transferohen në pronësi të bashkisë shijak me pronën Nr 15/14 zk 3369 në pronësi të Komiteti Mysliman të Shqipërisë (ish pronare dhe fqinje me kete prone”).rrjedh nga.

1. Situata e krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit ,në bashkinë Shijak ka sjellë pasoja dhe në objektet kulturore arsimore të qytetit , nga verifikimi i kryer nga Insituti i ndërtimin objekti Pallat Kulture është kthyer tërësish jashtë funksionit duke u konsideruar me një dëmtim DS4 për shembje miratuar kjo me VKB Nr. 50 datë 08.06.2020 “Për miratimin e Akt- ekspertizave të thelluara”. Pika 2.e vendimit.

Projekti i ri i pallatit të kulturës financuar nga qeveria shqiptare, nuk përshtatet me sipërfaqen e vjetër dhe teknikisht është e pamundur që të rindërtohet në të njëjtin vend.

Me vendimin e keshillit bashkiak Shijak Nr. 14 datë 01.03.2021 është miratuar plani i detyruar vendor për objektin “Pallati i ri i kulturës” në lagjen Popullore ,duke përcaktuar dhe vendodhjen e re të objektit “Pallat Kulture”

Vendimi Nr 14 datë 01.03.2021 është miratuar me VKM Nr.320 datë 18.05.2022 “Për një ndryshim në vendimin Nr.45 datë 22.01.2022 “Për shpalljen e zones së re për zhvillim në Njësinë Administrative Shijak”

Me shkresën Nr.8387/2 datë 19.05.2021 është miratuar fondi i ndërtimit të pallatit të kulturës në zbatim të VKM Nr. 279 datë 12.05.2021.në këto kushte :

Bazuar ne sa me siper dhe në kërkesën e besimtarëve të qytetit dhe komitetit mysliman për ndërtimin e një xhamie të re për qytetin shijak, me cilesine dhe të ish pronarit të vjetër dhe fqinjit aktual të pronës në mbështetje të nenit 8,pika 2 ,neni 9 pika 1 shkronja b nën pika 1.2 shkronja c nën pika 6 nën pika 54 shkronja e të ligjit numër 139/2015 “Për vetë Qeverisjen Vendore”I ndryshuar ligjit nr 8743 datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” të ndryshuar me ligjin nr 8744 datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e Qeverisjes Vendore” të ndryshuar, VKM Nr. 839 datë 22.07.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi të bashkisë Shijak, ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit “I ndryshuar , Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, relatojme për tjetërsimin e këmbimin e pronës ish - pallat kulture dalë jashtë funksionit nga tërmeti i 26- nëntorit 2019 ,pronë e përfituar me VKM Nr. 839 datë 22.07.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi të bashkisë shijak me pronën Nr 15/14 zk 3369 në pronësi të Komitetit Mysliman të Shqipërisë .

VENDIM

Nr.839, datë 22.7.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHIJAK TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shijak të qarkut të Durrësit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Lista me 24 (njëzet e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 105 (njëqind e pesë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Bashkia Shijak

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
8,9,104,105	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
15-17	Varrezat publike	Në pronësi
40-43, 45 (vetëm trojet)	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
18-39, 44 40-43, 45 (vetëm sheshet) 46-49	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
50-53	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi

54-65	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
97,98	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
96,99	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive).	Në pronësi